



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	8642-2/25
Nr. I faqeve Broj. stranica No. pages	-05-
Data Datum Date	16.07.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	02.07.2026
REFERENC-Ë:	25/8642/759/DMM
PËR/ZA/TO:	Spitalin e Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korrigjim Vendimi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën e pranuar nga nga e juaj për korrigjimin e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor, me nr.prot.: 25/8642/759/DMM të datës 18.06.2026 dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për korrigjimin e Vendimit për Pëlqim Mjedisor për Spitalin e Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren, me nr.prot.: 25/8642/759/ të dates 19.05.2026.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura; paragrafin 1, të nenit 50, të Ligjit Nr. 05/L-031, Per Procedurën e Përgjithshme Administrative; nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nxjerr këtë:

V E N D I M

Korrigjohet Vendimi i Pëlqimit Mjedisor me nr.prot.: 25/8642/ZSP, për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin e Prizrenit, Prizren, i datës 19.05.2026 dhe miratohet kërkesa e Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren, me nr.prot.: 25/8642//ZSP të datës 19.05.2026.

Andaj, në faqen e 2-të të Vendimit me nr. prot.: nr.prot.: 25/8642/ZSP të datës 19.05.2026, para ngastrës kadastrale shtohet ky tekst:

Kodet specifike të mbeturinave që përfshihen në këtë pëlqim sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave janë: **18 01 01** (mjete të mprehta), **18 01 02** (pjesë të trupit, organet përfshirë qeset e gjakut dhe gjakun e rezervuar), **18 01 03*** (mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi), **18 01 04** (mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave nuk kërkon përkujdesje të posaçme), **18 02 01** (mjete

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net



të mprehta) dhe 18 02 02* (mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi). Trajtimi i këtyre mbeturinave infektive dhe potencialisht infektive do të bëhet përmes trajtimit fizik të sterilizimit me avull në autoklav (përmes pajisjes ECODAS T300), proces ky plotësisht i automatizuar që integron copëtimin/thërmimin paraprak mekanik të materialit për t'i bërë mbetjet e panjohshme. Sterilizimi arrihet në mënyrë të pastër ekologjike (pa përdorimin e kimikateve dhe pa emetime tymi apo karboni) duke aplikuar avull të injektuar direkt në temperatura të larta prej 130-177 °C dhe presion pune deri në 3.5 bar për një kohëzgjatje prej 10 minutash, duke garantuar inaktivizimin e plotë mikrobial (reduktim prej 10⁶-10⁸) dhe zvogëlimin e vëllimit të mbetjeve deri në 80% përpara deponimit të tyre përfundimtar si mbetje të zakonshme komunale.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me nr. protok. 25/8642-3/759, të datës 18.06.2026 të Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren, për Korrigjimin e Vendimit për trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit, Prizren, është konstatuar se kërkesa për Korrigjim ka të bëjë me lëshim teknik, Andaj, në faqen e 2-të të Vendimit me nr.prot.: 25/8642/ZSP, për trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit, Prizren, të datës 19.05.2026, para ngastrës kadastrale shtohet ky tekst:

Kodet specifike të mbeturinave që përfshihen në këtë pëlqim sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave janë: 18 01 01 (mjete të mprehta), 18 01 02 (pjesë të trupit, organet përfshirë qeset e gjakut dhe gjakun e rezervuar), 18 01 03* (mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi), 18 01 04 (mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave nuk kërkon përkujdesje të posaçme), 18 02 01 (mjete të mprehta) dhe 18 02 02* (mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi). Trajtimi i këtyre mbeturinave infektive dhe potencialisht infektive do të bëhet përmes trajtimit fizik të sterilizimit me avull në autoklav (përmes pajisjes ECODAS T300), proces ky plotësisht i automatizuar që integron copëtimin/thërmimin paraprak mekanik të materialit për t'i bërë mbetjet e panjohshme. Sterilizimi arrihet në mënyrë të pastër ekologjike (pa përdorimin e kimikateve dhe pa emetime tymi apo karboni) duke aplikuar avull të

Faqe 3 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



injektuar direkt në temperatura të larta prej 130-177 °C dhe presion pune deri në 3.5 bar për një kohëzgjatje prej 10 minutash, duke garantuar inaktivizimin e plotë mikrobial (reduktim prej 10⁶-10⁸) dhe zvogëlimin e vëllimit të mbetjeve deri në 80% përpara deponimit të tyre përfundimtar si mbetje të zakonshme komunale.

Bazuar në paragrafin 1, neni 50, të Ligjit nr. 05/L-031, për procedurën e Përgjithshme Administrative, aprovohet kërkesa për korrigjim të Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me nr.prot.: 25/8642-3/759/DMM të datës 18.06.2026, i Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren për trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit, Prizren.

Koncepti i projektit mbeten i pa ndryshuar dhe nuk kemi të bëjmë me ndryshim nga koncepti ideor i projektit, kurse rrethanat dhe kushtet e përcaktuara në Pëlqim Mjedisor mbesin të njëjta.

Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/8642/759-3/- ZSP/ /26 datë: 02.07.2026

Prishtinë



T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Prizrenit
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPH

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

